



KOSOVANIA

Ballina: Albert & Dona Gjokaj

Albert Gjokaj:

*Pas çdo burri të suksesshëm
qëndron një grua e fortë!*





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend



ANTALYA | TÜRKİYE



SHERWOOD
Gölköy Resort



SHERWOOD
Gölköy Lara



SHERWOOD
Dünya Resort



SHERWOOD
Pamuklu



BUE
TÜRKİYE
Belek



GREENWOOD
Water Resort



GREENWOOD
Water Resort

sherwoodhotels.com.tr | greenwoodhotels.com.tr

+90 444 86 07

Albert Gjukaj:

Pas çdo burri të suksesshëm qëndron një grua e fortë!



Albert Gjukaj është maestro, krijuesi dhe afaristi i suksesshëm shqiptar, njeriu me fantazi të jashtëzakonshme kur bëhet fjalë për krijimin e këpucëve dhe çantave speciale, luksoze dhe të cilësisë së lartë...

Albert Gjukaj është artist në zanatin tij, meqë krijon përtej fantazisë e imagjinatës së zakonshme. Tashmë është i njohur dhe i vlerësuar edhe ndërkombëtarisht për talentin dhe punën që bënë.

KUSH ËSHTË NJERIU ME PASION E PËRKUSHTIM TË RRALLË PËR KËPUCËT?

Albert Gjukaj, nga Strellci i Deçanit, me vendbanim në Cyrih të Zvicrës, aktivitetin e zhvillon në Luzern, si bashkëpronar i kompanisë "Mr. Dapper". Përtej mjeshtrit, krijuesit e dizenjatorit unik të këpucëve luksoze, Albert Gjukaj është bashkëshort e baba i shkëlqyer.

Bashkëshortja e tij, Dona, është edhe mbështetësja më e madhe, krahu i djathtë i Albertit.



SI LINDI HISTORIA E TYRE E DASHURISË?

Për revistën tonë, "Kosovarja", çifti Albert e Dona Gjokaj tregojnë se ata u dashuruan në shikim të parë.

Dona:

"U martuam shumë të rinj, në vitin 2005. Ishte dashuri në shikim të parë. Jemi njëjtë të dashuruar si në ditën e parë".

Ndërkaq, Alberti tregon se bashkëshorten e ka pasur përherë mbështetje.

"Kam filluar të punoj me këpucë në vitin 2007. Si shumica e bizneseve ka ulje-ngritje, por gruaja ime e dashur, Dona, më ka mbështetur gjithmonë. Ajo e ka parë gjithmonë talentin tim për këpucët dhe modën.

E, nëse doni të vazhdoni me kompanitë e mëdha të modës në mbarë botën, shpesh u duhet të udhëtoni në panairë lëkure ose panairë këpucësh, ndonjëherë keni ekspozita vetë dhe punoni shumë, kështu që do kaloni pak kohë në shtëpi e do udhëtoni shumë, andaj edhe keni nevojë për një grua të fortë, e cila është gjithmonë për t'u mbështetur dhe motivuar. Dona e dinte gjithmonë se ëndrra ime ishte të hapja një dyqan të bukur dhe elegant këpucësh për meshkuj. Nga viti 2019 hapëm dyqanin "Mr. Dapper" dhe u futa në akomodim luksoz dhe individual", thotë Alberti. Në anën tjetër, Dona shton se ajo do të jetë përherë pranë të shoqit, për ta bërë rrugëtimin e tij edhe më të suksesshëm.

"Jam mbështetëse dhe dua ta shohë duke u realizuar profesionalisht dhe emocionalisht, meqë për Albertin krijimi i këpucëve është edhe pasion, e përmbushë shpirtërisht.

Kurse, Alberti potencon se viti 2024 ishte i suksesshëm, sepse ka mundur të njohë artistin e madh Pirro Ruco dhe disa biznesmenë të mëdhenj nga Shqipëria, por jo vetëm.

"Gjithmonë kam dashur të punoj më shumë me komunitetin shqiptar, meqë shqiptarët viteve të fundit janë bërë shumë të suksesshëm profesionalisht. Gjithashtu, sukses ishte arritja e dytë në finalen e Kampionatit Botëror të Këpucëve në Londër.

Por, më se shumti u lumturova kur u nominova për "Swissalbs".

Pas shfaqjes në "Swissalbs" kam pasur

shumë reagime nga njerëzit tanë dhe kjo më gëzon.

Aktualisht po lansojmë koleksionin e ri të këpucëve dhe çantave për meshkuj, projektimi dhe prodhimi i të cilit do të jetë gati rreth muajit mars.

Çdo pjesë është bërë dhe qepur tërësisht me dorë”, thotë Alberti. Të kujtojmë se “Mr. Dapper” është dyqan i specializuar me këpucë me masa personale dhe çanta me lëkurë krokodili dhe aligatori, ku mund të bëhet çdo çantë dhe këpucë sipas kërkesave të klientit.

Ç’THOTË ALBERTI PËR VIP-at SHQIPTARË?

Me Albertin flasim edhe për VIP-at shqiptarë. “Shumica e VIP-ave shqiptarë nuk e posedojnë stilin elegant që unë e preferoj.

Por, kisha pasur dëshirë të krijoj diçka për Sabri Fejzullahun ose Ilir Shaqirin, meqë janë ikona të muzikës dhe kanë stil ideal.

Gjithsesi, emra të fuqishëm të botës së biznesit në Shqipëri, nga Shkodra e Tirana, kanë bërë porosi të këpucëve dhe çantave”, thotë tutje Alberti.

Po, për gruan e tij, a do të krijonte diçka speciale? “Do ta jepja botën për gruan time, por unë prodhoj vetëm këpucë për meshkuj.

Por, ndryshon puna kur është fjala për çanta me lëkurë krokodili, meqë krijoj edhe për femra”.

E, sa i përket planeve, Alberti shton se po planifikojnë një zgjerim në nivel ndërkombëtar, meqë shpejt “Mr. Dapper” do të jetë edhe në Majami e Dubai, ku do të ketë showroom-et e veta e ku do të prezantohen produktet e brendit.

PËR FUND

Në fund, pa dyshim, vjen urimi për vitin 2025 nga Alberti e Dona.

“Urime të përzemërta të gjithë shqiptarëve kudo ku janë, me porosinë që ta mbështesim më shumë njëri-tjetrin në Vitin e Ri!”.

Nderim Neziri



Suksese...

Ish-bashkëpunëtorët tanë, me suksese të njëpasnjëshme



Ardiana Thaçi



Valdete Osmani



Arben Gjinaj



Para lufte, e veçmas pas lufte, Revista jonë gjithmonë është vërsuar nga bashkëpunëtorë të shumtë, e që pjesa dërmuese e tyre hapin e parë e kanë bërë në "Kosovare" ose, thënë ndryshe, "praktikën" në gazetari e kanë kryer në Redaksinë tonë. E, se është kështu flet fakti se shumë gazetarë të afirmuar, e që tash janë të angazhuar nëpër media të ndryshme dhe vende të ndryshme, dikur hapat e parë i bënë në Revistën tonë "Kosovarja", konkretisht Valdete Osmani, Naile Dema, Arben Gjinaj, Ardiana Thaçi, Pranvera Behluli e të tjerë.

Por, shtysë për këtë shkrim është Ardiana Thaçi, e cila ditë më parë u shpall "Gazetare e vitit 2024", nga AGK-ja (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës). Ardiana Thaçi momentalisht është gazetare në Televizionin "Klan Kosova".

SONTE, 31 DHJETOR 2024



Dedikuar të gjithëve: ty, mua, gjithë atyre që presin diçka... një shenjë, një mesazh, një buzëqeshje, një kthim, një "të dua", një "më mungon"... Gjithë atyre që e mbajnë e s'humbin shpresën, edhe pse i pastrehë, edhe pse i papunë, edhe pse i dëshpëruar e i vuajtur, i robëruar në Liri për një ditë më të mirë, për të cilën përjetuam e çka s'përjetuam, vuajtëm me shekuj për këtë t'madhe Ditë, që vetë me dorën tonë s'po e lëmë të bëjë dritë!

Fund dhjetori.

Fund i një motmoti.

Fund i vitit 2024.

Ishte ky vit, varet për kë, ishte qysh ishte: I lehtë a i vështirë, i mirë a i keq, i mbarë a i mbrapshtë, i lumtur a i dhembshur...

Megjithatë, i takon vitit që po ikë, i takon të djeshmes, të shkuarës që s'kthehet më...

Çdoherë, me këtë rast, në këso momentesh, në vigjilje të kremtes së Vitit të Ri, shkruanim shkrim me pak fjalë, paksa më festiv, paksa më me mall, nostalgjik, romantik. U ktheheshim ditëve, muajve, momenteve që i përjetonim brenda vitit.

Shkruanim për skamnorët se si do e presin këtë natë kremteje pranë sofrës së tyre të thatë, me bukë e çaj, kurse të pasurit në ahengje, me tryeza plot, me muzikë e sevda...

Por, edhe sivjet me më shumë të varfër e me më shumë të pasur...

Sidoqoftë, nuk dua një funddhjetor me drita, ndriçime të rrugëve, por një funddhjetor me njerëz që ndriçojnë nga lumturia, jeta më e mirë...

Gëzuar - për ditë më të mira në vitin që po hymë!

*

Ndodh të dashurohesh me errësirën kur të mungon drita!

Të jetosh me ëndrrën kur s'të pëlqen realiteti!

Të bashkohesh me dhimbjen kur nuk e ke gëzimin!

Të flasësh me heshtjen kur nuk të vijnë fjalët!

Të mësohesh me pritjen kur vonon ardhja!

I dorëzohesh durimit nëse e ke humbur shpresën... Gëzuar - për shpresën të bëhet realitet!

*

Të gjithë duan ta ndryshojnë botën, por askush nuk dëshiron ta ndryshojë veten!

Gëzuar - për një vit që njerëzit ta ndryshojnë vetveten!

*

Ka ardhur një kohë kur njerëzit duan ta kenë krejt botën të veten, por bota nuk është vetëm e një njeriu!

Gëzuar - për botë më të mirë!

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Gratë tona që ndryshuan historinë



SHOTE GALICA, HEROINA E POPULLIT SHQIPTAR

Shote Galica, e lindur në Radishevë të Drenicës, më 10 nëntor 1895, e njohur me emrin e lindjes si Qerime Radisheva, ishte një luftëtare shqiptare kaçake. Ishte motra e 6 vëllezërve. U martua me Azem Galicën në vitin 1915.

Mori pjesë në Kryengritjen e Dukagjinit dhe të Junikut në vitet 1921-1923.

Në korrik të vitit 1924 mori pjesë në betejën për Drenicën, e që ndryshe e quanin Shqipëria e Vogël.

Së bashku me qindra luftëtarë nga ish-Vilajeti i Kosovës, në dhjetor 1924 luftoi kundër forcave Mbretërore Jugosllave.

Shote Galica mori pjesë në më shumë se 40 aksione të rëndësishme kundër armikut. Kundërshtoi me konsekuencë politikën e dhunës e të terrorit të regjimit shovinist të Beogradit ndaj popullsisë shqiptare, shpërnguljen e saj dhe kolonizimin sllav të trevave shqiptare.

Humbi në luftime nga masakrat shoveniste serbe 22 anëtarë të familjes.

Mbahet mend edhe për kapjen e një komandanti serb dhe një numri ushtarësh në Çikatovë. Në vitin 1925, pas vdekjes së burrit, Azem Galicës, mori detyrën e tij dhe luftoi bashkë me Bajram Currin në Has të Prizrenit dhe Lumë. Në korrik të vitit 1927 u tërhoq në Shqipëri dhe kaloi muajt e saj të fundit në Fushë-Krujë, ku edhe vdiq në moshën 31-vjeçare.

Shote Galica ishte një legjendë virtuale në kohën e saj. Mbahet mend për thënien "Jeta pa dije është si një luftë pa armë".

NËNË TEREZA, MISIONARJA E PAQES

Emri i vërtetë i Nënë Terezës është Anjezë Gonxhe Bojaxhiu. Është një nga figurat më të rëndësishme të shekullit të kaluar, e njohur për veprat e saj të bamirësisë për njerëzit në nevojë.

U lind në Shkup, më 26 gusht 1910, asokohe qendra e Vilajetit të Kosovës në Perandorinë Osmane.

Jetoi në vendlindje për tetëmbëdhjetë vjet. U shpërngul në Irlandë dhe më pas në Indi, ku jetoi pjesën më të madhe të jetës së saj.

Është e njohur si Nëna Terezë e Kalkutës, murgeshë dhe misionare katolike.

Nënë Tereza është vlerësuar me çmimet dhe nderimet më të larta, duke u nderuar më 1962 me Çmimin e Paqes "Ramon Magsaysay" dhe në vitin 1979 me Çmimin "Nobel" për Paqe.



XHEVË KRASNIQI-LLADROVCI, USHTARAKJA ME GRADËN MË TË LARTË

Xhevë Krasniqi-Lladrovci (1955-1998) ishte luftëtare e UÇK-së, e cila luftoi pareshtur deri në frymën e saj të fundit. Është luftëtarja e vetme e UÇK-së që do të ketë gradën e gjeneral-majorit, e kjo është grada më e lartë që ka marrë një grua shqiptare.

Ajo ka ndjekur shembullin e Shotë Galicës dhe luftoi përkrah burrit të saj, komandantit Fehmi Lladrovci, të cilit nuk iu nda deri në vdekje.

Xhevë Krasniqi-Lladrovci u lind më 1 qershor 1955, në Drenoc të Malishevës.

Rrjedh nga një familje e shquar intelektualësh dhe patriotësh. I ati i saj, Abdyl Krasniqi, ishte arsimtar dhe i burgosur politik, për shkak të veprimtarisë patriotike. I njëjti i nxori eshtrat e Azem Bejtës nga shpella e thellë 70 metra, ku e kishin fshehur.

Edhe e ëma e Xhevës, Hanife Bujupi-Krasniqi, rridhte nga një familje patriotike nga Orllati i Drenasit.

Xheva u rrit dhe u edukua në një familje me tradita shqiptare. Ishte fëmija i parë ndër 17 djem e vajza të babait të saj.

E, meqë nëna e saj kishte vdekur e re, babai i ishte martuar për herë të dytë. Ndonëse e rritur në një familje shumëanëtarësh dhe në rrethana të vështira të asaj kohe, ajo ia kishte dalë mbanë që të përfundonte edhe fakultetin, për më tepër kishte përfunduar dy të tillë: Fakultetin e Letërsisë dhe atë Juridik.

Xheva ishte jashtëzakonisht aktive në të gjitha organizimet që u bën për çlirimin e atdheut.

Si rezultat, ajo, gjatë një veprimtarie ilegale të vitit 1981, ishte njohur me Fehmiun, me të cilin edhe u fejua pas 2-3 muajsh. Por, menjëherë pas fejesës, Fehmiu ishte burgosur për veprimtari antishtetërore

me 10 vjet burg, prej të cilave do i vuante 5 e gjysmë.

Dhe, gjatë kohës sa ishte në burg Fehmiu, Xheva kishte vendosur të jetonte me prindërit e Fehmiut, kur edhe do të bëhej mësuese e nënë Shefkijes, që ia mësoi Abetaren, që t'ia shkruante vetë letrat djalit të saj në burg.

Me lirinim me amnesti nga burgu, Fehmiu kthehet në vendlindje, në Shkabaj dhe martohet me nusen e tij që e kishte pritur me vite.

E, vetëm dy javë pas martesë, të dy shkojnë në luftë në Kroaci, më 1991, ku luftuan në anën e kroatëve kundër agresorit serb. Më 1993 ajo u aktivizua në UÇK dhe po atë vit u vendos në Gjermani bashkë me Fehmiun.

Më 11 mars 1998, vetëm 4 ditë pas rënies së komandant Adem Jasharit, Fehmiu e Xheva, së bashku me luftëtarë të tjerë, do të vinin direkt në radhët e UÇK-së.

Ata formojnë pikën ushtarake në vendin e quajtur "Te Tuneli", në Baicë të Drenasit, ku Xheva do të ndikonte në mobilizimin dhe masivizimin e grave shqiptare, që krahas burrave, do të luftonin për çlirimin e atdheut.

Dhe, krahë për krahë me bashkëshortin e saj, Xheva do të luftonte në çdo betejë të UÇK-së, deri në ditën e flijimit, më 22 shtator 1998, ditë kur Fehmiu bie heroikisht, e Xheva vazhdon luftën deri në përfundim të të gjithë fishekëve.

Por, një copë mortaje e godet në kokë dhe bie dëshmore.

Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, pas rënies, i dha gradën Gjeneral-major, ndërsa më 22 shtator 2008, Xhevë e Fehmi Lladrovci shpallen heronj të Kosovës nga presidenti i atëhershëm i Kosovës, Fatmir Sejdiu.

Nga arkivi i harruar...

Shtëpia që pret “kthimin” e 25 anëtarëve nga viti 1921!

Si “Serbia e Parë”, po ashtu, edhe “Serbia e Dytë”, që të dyja masakruan shqiptarë. E, atë fat e kishte edhe familja e hoxhës nga Keqekolla, Mulla Ademit, më 1921.

Në këtë shtëpi (të cilën e shihni në foto), më 10 janar 1921, pra para gati 104 vjetësh, çetnikët serbë masakruan 25



anëtarë të familjes së Mulla Ademit, nga Keqekolla e Prishtinës.

HEDHJA E KUFOMAVE NË BUNAR!

Pas vrasjes së 25 anëtarëve të familjes së Mulla Ademit, ata fshatarë që kishin mbetur në fshat ishin tubuar në shpejtësi që të shihnin se çka kishte ndodhur. Dhe, pasi panë tmerrin që kishte ndodhur në familjen e Mulla Ademit, meqë nuk kishin mundësi t’i hapnin 25 varre atë ditë, vendosën që kufomat t’i hedhin në bunarin që ndodhej në oborr dhe ta mbulonin atë me gurë e me gjithçka që gjetën para vetes.

Por, sot nuk dihet vendi ku ndodhej dikur bunari! Andaj, një ekip institucional do të mund të qonte punën e hulumtimit të hapjes së bunarit dhe në bashkëpunim me banorët e fshatit të zbardhin më shumë detaje për atë ditë të kobshme vitit 1921, në të cilën u masakruan 25 anëtarë të familjes së hoxhës në Keqekollë. Në anën tjetër, pse nuk renovohet shtëpia nga Ministria e Kulturës së Kosovës dhe të shndërrohet në muze? Dhe, nëse jo vizitorë të tjerë, shkollat do t’i dërgonin nxënësit që ta vizitonin, që të njihen më për së afërmi me masakrën e madhe që kishte ndodhur në familjen e Mulla Ademit në Keqekollë.

S. Krivaça



BK Prishtina Travel



BASEL
BERLIN
STUTTGART
MÜNCHEN
DÜSSELDORF
HAMBURG
MÜNSTER
NÜRNBERG
MEMMINGEN
HANNOVER
LJUBLJANA
LUXEMBURG
HALMSTAD
VÄXJÖ
MALMÖ
GÖTEBORG

PRISHTINA



BK PRISHTINA TRAVEL

+383(0)48637636



BK.PRISHTINATRAVEL



BK PRISHTINA TRAVEL

RR. AGIM RAMADANI NR 14-2,1, PRISHTINË 10000

Cili kompozitor yni fjeti 13 muaj mbi një varr?

4 korriku i vitit 1979 ka lënë një shenjë të thellë në kujtesën e qytetit të Kuçovës. Pas një mbledhjeje demaskuese, mes shumë kolegëve e bashkëqytetarëve të tij, ishte arrestuar kompozitori dhe poeti i njohur Zef Lekaj.

13 MUAJ MBI VARR!

Në vitin 1946 Zef Lekaj merr pjesë në kryengritjen e Postribës, si e para lëvizje antikomuniste në Evropën Lindore, e cila u dekonspirua, u tradhtua dhe më mbrapa pasojat dihen.

Në ato rrethana ai arratiset përtej kufijve, në Mal të Zi. Aty detyrohet për trembëdhjetë muaj të fle i fshehur në një varr, sepse në atë kohë Enver Hoxha dhe Tito kalonin periudhën e "muajve të mjaltit".

Në atë kohë familja e tij transferohet në Kuçovë.

E, fëmijët e tij, për të fituar të drejtën e shkollimit, u deshën të endeshin fushave të fshatrave përreth, që të

bënin "stazh"!

Por, pas 13 muajsh, i fshehur mbi një varr në Mal të Zi, kthehet në Shqipëri, pas një amnistie që pushteti i atëherëshëm kishte shpallur për pjesëmarrësit e Kryengritjes së Postribës.

FRYMA ARTISTIKE E VENDLINDJES

Kompozitori Zef Lekaj, autor i këngës "Qingji i vogël", në vitet 60 kishte sjellë frymën artistike të vendlindjes së tij, Shkodrës, dijen dhe përvojën e tij jetësore, punën e palodhur dhe frytet e frymëzimeve të tij artistike në kulm. E, sot ato këngë janë pjesë e fondit të artë të muzikës shqiptare...

Por, në fillim korrikut të vitit 1979, autori i "Qingjit të vogël" ishte vënë në pranga, madje tri ditë para se të dilte në pension!

Në mënyrën më të pabesë, më të paturpshme, gjatë një mbledhjeje, arrestohet Zef Lekaj, artist, kompozitor, poet, me akuzën: "Propagandë kundër pushtetit popullor!"

E dërgojnë në burgun e Beratit. Dhe, burgu zgjati deri në vitet 90, kur edhe nisi të bie komunizmi. E, në vitin 1992, bashkë me familje, kthehet në Shkodër.

Në vitin 1995 Zef Lekaj dekorohet nga Presidenti i Republikës (Prof. Dr. Sali Berisha), me titullin "Pishtar i Demokracisë".

AUTO
ALBERTI

GĚZUAR
2025





Arbëreshët fëmijën e porsalindur e kthejnë me fytyrë kah Shqipëria

Tradita e arbëreshëve: Kur lind fëmija ktheje me fytyrë kah Shqipëria! E, madhërishtme, a?

A e dini se arbëreshët e kanë traditë që kur lind fëmija e kthejnë me fytyrë nga Shqipëria, duke uruar që të mos e harrojë kurrë atdheun e tij?! Arbëreshët, shqiptarët e Italisë, janë pakicë etno-gjuhësore shqiptare, të vendosur historikisht në jug të Italisë. Të ardhur nga Shqipëria, nga rajoni historikisht shqiptar i Epirit dhe nga komunitetet e shumta shqiptare të

Atikës dhe Moresë, sot në Greqi, ata vendosën në Itali ndërmjet shekujve XV dhe XVIII, pas vdekjes së heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) dhe pushtimit të Arbërisë dhe, në përgjithësi, të të gjitha territoreve të dikurshme të Perandorisë Bizantine në Ballkan nga turko-osmanët. Por, edhe pse nga koha e shpërnguljes

së tyre në Jug të Italisë, konkretisht në Kalabri e Sicili, kanë kaluar mbi 500 vjet, ata, si asnjë popull tjetër në botë, e kanë ruajtur gjuhën, traditën dhe kulturën e tyre shqiptare. Habit fakti se në traditën e tyre ka mbetur që fëmijën e porsalindur ta kthejnë me fytyrë kah Shqipëria, që të mos e harrojnë prejardhjen e tyre. E, madhërishtme a?

anaderm

**GËZUAR
2025**

Abdomenoplasty

Largimi i lëkurës së tepërt në abdomen



Prof. Dr. Selahattin Özmen
Specialist i Kirurgjisë Plastike dhe Estetike



Rr. Zef Jubani – Veternik,
Prishtinë, Kosovë



+383 (0) 45 707 744
+383 (0) 43 707 744

ZERO
SUGAR FREE



go+

Energy
Drink

Objekti i Hamamit të Hyrës dikur...

Kush e bëri "Hamamin e Hyrës"?

AVENTURA

TE "HAMAMI I HYRËS"!

Në vitin 1989, teksa kaloja me veturë nëpër Kllokot, më ndalën policia e asaj kohe.

"Ku shkon?", më pyeti njëri prej tyre, pasi m'u ofrua te dritarja e veturës.

Ishte ora 20 e mbrëmjes, andaj më duhej të gjeja ndonjë arsye të fortë pse lëvizja në atë kohë.

I thashë se po shkoja në Gjilan.

"Pse po shkon në këtë kohë?", më pyeti tjetri.

"Shkoj për aventura, te "Hamami i Hyrës", i thashë.

"Ti nuk e paske syrin e aventurave. Po ku është ai "Hamami i Hyrës" që e përmende!?", më tha i treti dhe më urdhëroi të dilja nga vetura.

Dhe, posa dola nga vetura më mbështetën për veture dhe filluan t'më kontrollojnë.

E, teksa e kujtoj atë moment, them me vete se po të kishte qenë me mua gruaja, me siguri, do ia fusnin edhe asaj duart nëpër trup...

Pas pak, njëri prej policëve, e që dukej i dehur, më tha:

"Unë po të njoh ty në bazë të emrit në letërnjoftim. Por, që të jemi të sigurt po e verifikojmë nëpërmjet qendrës".

Dhe, teksa po prisja, i mbështetur për veture, i bëra pyetje vetes: A nuk kishe çka t'u thoshe tjetër, o Sokol, pos që po shkoje në Gjilan për aventura te "Hamami i Hyrës" a?! Hej gojë, çka fole!"

Pastaj, m'u kujtua në shpejtësi se si një i uritur, e që kishte shkuar mysafir, kur i kishin thënë: "Eja ulu në sofër!", ai, duke menduar se i zoti i shtëpisë do ta luste pafundësisht, i thotë: "Jo, kam ngrënë".

Por, kur erdhi pitja në sofër, mysafiri i thotë vetes: "U thafsh oj gojë pse fole!"

Pas disa minutash m'i sollën dokumentet dhe më thanë: "Ik nga këtu dhe mos u paraqit më këndej pari se këtu është Serbi!"

E, sonte ja ku jam, në Kllokot, në restorantin që këndojnë vetëm këngëtare nga Shqipëria...

I VDEKURI MBI KALË!

Ngjarja e dytë ndodhi më 1994. Isha kthyer nga Gjermania dhe Austria, ku i kisha kryer disa punë në klubet shqiptare.

Po ashtu, e vizitova edhe motrën, së cilës vite më parë i kishte vdekur burri dhe e kishte lënë me dy fëmijë të vegjël.

Nuk kishte grim në fytyrë, nuk ishte e veshur mirë, jo se nuk kishte, por ishte e demoralizuar nga vdekja e burrit.

U përqaftuam përmallshëm si vëllai me motrën. Nuk kisha fuqi t'i thosha asgjë, madje as ta ngushëlloja... Isha i preokupuar me gjendjen e saj si në kohën e Konstandinit dhe Gerentinës, kur motra mallkonte vëllanë pse nuk e kishte mbajtur fjalën të shkante ta merrte në gjini. Konstandini kishte vdekur nga mortaja, kurse e motra nuk e dinte.

Nëna kishte mbetur vetëm dhe fliste me

qyqen, e cila vajtonte mbi degën e thatë të lisit në oborr.

Kur nëna e kishte përmendur premtimin e të birit të vdekur, ai ishte ngritur nga varri dhe ishte nisur të shkante te Gerentina.

Rrugës për te motra, dy zogj mbi një degë, i thonë njëri-tjetrit: "Shih si rri i vdekuri mbi kalë!"

Nuk dija, në fakt, a më kishte pyetur motra se a doja kafe a jo, sepse isha tretur me ngjarjen e Konstandinit e Gerentinës.

Por, di se i bëra pyetje vetes pse ajo nuk kishte grim në fytyrë, e fytyra e saj dukej e vyshkur...

"Kemi dasmë në familje, ndaj edhe erdha të të tregoj. Kur të vish vishu bukur, që të dukesh më e mira..."

E di se ç'fëmijëri të lumtur kemi pasur...

Kemi vrapuar pas fluturave...!, i thashë, teksa shikoja fytyrën e saj të vyshkur.

Dhe, i zhgënjyer me atë që pashë te motra, u nisa për në Prishtinë.

Në Sllatinë më ndalën policia serbe. E ndala pak si më larg tyre...

Pa një e pa dy, njëri prej tyre shau serbisht që nuk ua ndala para këmbëve...

"Vonë u pashë! Nuk duhet të zini pozitë në kthesë, ku nuk ka pamje të mjaftueshme!", fola sa për të thënë diçka.

"Ti na mëson ku të rrimë, a!?", më tha njëri prej tyre me plot ironi dhe u bë gati t'më mëshonte.

Por, deshi Zoti dhe nuk e zgjatën shumë e mua më lanë të vazhdoja rrugën...

S. Krivaça

Orbico Kosova feston 20 vite të suksesshme në treg

Orbico Kosovo, pjesë e Orbico Group – një nga distributorët më të mëdhenj në tregun Evropian, ka festuar solemnisht përvjetorin e 20-të, duke shënuar sukseset dhe arritjet e shumta në një festë glamuroze.



FESTË E SHUMË VITEVE TË SUKSESSHME

Me datë 11 Shtator 2024, kompania ka organizuar një event të paharrueshëm, ku u festuan sukseset e shumta në treg. Ceremonia zyrtare, e udhëhequr nga Rajmonda Ibishi, Menaxhere e Burimeve

Njerëzore për Orbico Kosova dhe Orbico Macedonia, u hap me fjalim mirëserdhjeje nga Stanislav Boyadzhiev, Drejtor i kompanisë FMCG për regjionin e Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë, dhe Armand Hamza, Drejtor Operativ për regjionin, të cilët shprehën mirënjohjen e tyre ndaj punonjësve të kompanisë për kontributin e tyre në suksesin e përgjith-

shëm të kompanisë. Një fjalim special u dha nga Stjepan Roglic, Vice President i Bordit mbikëqyrës. Në event morën pjesë shumë bashkëpunëtorë të Orbico Kosovës, dhe atmosfera e festës u pasurua edhe më shumë me vallëzimet tradicionale dhe performancat muzikore vendore, që theksuan historinë e pasur të kompanisë.



TRANSFORMIMI NË SUKSES

Duke filluar si kompani e vogël, Orbico Kosova ka pësuar transformim të dukshëm për dy dekadat e kaluara, duke u transformuar në lider stabil të distribucionit të FMCG në rajon. Me një ekip prej 66 punonjësish, kompania parasheh qarkullim shitjeje neto në vlerë 10.3 Milion Euro në 2024, duke shpërfaqur kështu përkushtimin e punonjësve të saj dhe kontributin e tyre në suksesin e përgjithshëm të kompanisë. Përmes rritjes stabile dhe rregullore të brendshme të përgjegjshme, Orbico Kosova konsolidon zhvillimin dhe rolin e vet në dinamikat e tregut.



Stanislav Boyadzhiev, Drejtor i kompanisë FMCG për regjionin e Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë, thekson lidhur me suksesin e kompanisë: “Derisa shohim përpara, jemi të ngazëllyer për mundësitë që vijjnë. Ne do të vazhdojmë të investojmë në njerëzit tanë, në infrastrukturën tonë dhe në partneritetet tona për të siguruar vijimësinë e Orbico Kosovës si forcë ushëhqëse në industrinë e distribucionit. Ne jemi të përkushtuar që të ofrojmë vlerë të jashtëzakonshme për klientët tanë, duke mbështetur partnerët tanë dhe duke kontribuar pozitivisht në komunitetet ku operojmë”.

INOVACION PËR PARTNERITET TË SUKSESSHËM

Çelësi i suksesit të Orbico Kosovës qëndron në prezantimin e vazhdueshëm të teknologjive të reja. Kompania investon

burime të konsiderueshme në teknologjitë moderne për depot dhe sistemet e avancuara ERP që sigurojnë menaxhim efikas të logjistikës. Duke kombinuar këto teknologji me zgjidhjet e specializuara softuerike dhe automatizimin e rrjedhës së punës, Orbico Kosova u ofron partnerëve dhe klientëve të saj dërgesa të shpejta dhe

të besueshme që plotësojnë standardet moderne të tregut. Kjo strategji e bën kompaninë një partner të preferuar të shumë markave lidere botërore vendase dhe ndërkombëtare si Kellanova, Storck, Lindt, Shell Lubricants, Papadopoulos dhe shumë të tjera, të cilat janë unike për portfolion e vendit.



Orbico Kosova vazhdimisht investon në mjete të reja që automatizojnë dhe optimizojnë proceset, duke rritur efikasitetin e punës së përgjithshme të ekipit dhe duke krijuar një mjedis pune produktiv. Këto risi jo vetëm që përmirësojnë efikasitetin operacional, por gjithashtu krijojnë kushte për rritje të qëndrueshme dhe konkurrencë

në treg. Kompania gjithashtu përkushtohet në trajnimin dhe zhvillimin e punonjësve të saj, gjë që çon në një rritje të kualifikimeve dhe motivimit të tyre. Kompania po punon në mënyrë aktive në zhvillimin e zgjidhjeve inovative që plotësojnë nevojat specifike të klientëve dhe partnerëve. Kjo përfshin zbatimin e teknologjive të reja për gjurmimin

e dërgesave në kohë reale, si dhe integrimin e të dhënave nga burime të ndryshme për planifikim dhe menaxhim më të mirë të burimeve. Këto përpjekje jo vetëm që forcojnë pozicionin e kompanisë në treg, por edhe e bëjnë atë një partner të besueshëm për bizneset që kërkojnë shërbime logjistike efikase dhe me cilësi të lartë.



KONKLUZION

Festimi i 20 vjetorit të Orbico Kosovës nuk është vetëm celebrim i arritjeve dhe sukseseve, por gjithashtu një inspirim për projekte të ardhshme ambicioze dhe arritje edhe më të mëdha. Kompania do të vazhdojë të zhvillojë zgjidhje inovative që përmbushin nevojat e klientëve dhe partnerëve, duke e forcuar pozicionin e vet në treg dhe duke u dëshmuar vazhdimisht si partner i besueshëm.



Ndonjëherë nuk është trupi që kërkon shërim por është shpirti i lodhur që ka nevojë për dëgjim!



Gjysmën e parë të jetës sonë e kalojmë duke plotësuar parametrat dhe normat e familjes, mësimdhënësve dhe prangave të sistemit, duke u shkolluar, krijuar familje, duke kërkuar famë dhe sukses. Ndoshta jo gjithmonë sipas renditjes por disi ia dalim ne sipërfaqe secili në mënyrën e vetë.

Në gjysmën e dytë të jetës lodhemi duke pritur shpërbli-min e premtuar ku dashurinë e lumturinë ne si shoqëri e shtyjmë edhe një dekadë duke menduar se ende nuk e meritojmë, bile pa e paguar kredinë vazhdojmë të funksionojmë.

Në përditshmërinë tonë të egër, ku edhe pse i kemi bërë "detyrat e shtëpisë" shpesh përjetojmë momente të një presioni intensiv i cili e rritë edhe më shumë kërkesën e përmbushjes shpirtërore. Shpërbllim për të cilën kemi ëndërruar gjatë, për të cilën

kemi punuar shumë dhe jemi munduar të mos bëjmë as një "gabim" përndryshe lumturia nuk të takon, na thanë.

Të uritur më një shpirt të zhgënjyer nuk e gjejmë veten askund, pos të ngulfatur nga bollëku i jashtëm, ndjehemi të humbur në shpirt, më një boshllëk që në psikologji quhet "Horror Vacui" petku i zymtë psikologjik që rrallë ka harruar kënd pa e mbuluar me frikë dhe ankth.

Frika dhe ankthi nuk janë asgjë pos reagime të shëndetshme ndaj një situatë të sëmurë në jetën tonë. Por, ne të edukuar me recetë (sidomos gjinia mashkullore) i refuzojmë dhe i luftojmë me çdo kusht këto simptome duke menduar se është dobësi të jesh ndonjëherë i trishtuar apo i dëshpëruar. Sfidat mes forcës dhe të dobtës janë jetësore. Kjo vlen edhe për sfidat shpirtërore të cilat edhe pse nuk na i sheh askush, ato janë aty, kujdesu për to, mos prit që të tjerët të ndihmojnë sepse ndoshta ata po kalojnë një sfidë edhe më të padukshme që t'i mund ta imagjinosh. Ti dhurosh kohë dhe vëmendje vetes sidomos kur nuk ndjehesh mire është forma më e bukur e dashurisë ndaj vetes dhe jetës.

Shkëndije Pacolli



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges


BOOM

**E pandalshmja
Shpresa Osmani...**

E pandalshmja Shpresa Osmani...



Për "Beauty Center Shpresa" dhe sukseset e pandalshme të Shpresa Osmani dhe stafit të saj, kemi dëgjuar prej vitesh...



“Beauty Center Shpresa” është ndër qendrat e bukurisë më të mëdha e më profesionale në Zvicër, duke u shndërruar në një histori sukseesi e krenarie jo vetëm për pronaren, por edhe për bizneset shqiptare në Diasporë.

Në “Beauty Center Shpresa” lista e shërbimeve është e gjatë, duke nisur nga dobësimi efikas me laser, heqja e qimeve me laser (e që bënë eliminonim e tyre të përjetshëm), heqja e rrudhave në fytyrë, mbushja e buzëve, mbjellja e qerpikëve, thonjve, e shumë të tjera.

Ajo që duhet theksuar është se “Beauty Center Shpresa”, është gjithashtu edhe shkollë, ku nxënëset aftësohen për mbjelljen, kurimin, rregullimin e thonjve, mbushjen e buzëve me metodat më bashkëkohore, mbjelljen e qerpikëve, vetulave etj.

MASTER NË FUSHËN E BUKURISË

Meqë flasim për vitin 2024, për Revistën tonë, “Kosovarja, shpresa thotë se edhe ky ishte një vit si

çdo vit tjetër me shumë punë e angazhime. “Megjithatë, gjatë vitit 2024 i kam kushtuar më shumë kohë vetes, familjes dhe studi-meve në “Swiss color” në Kantonin St’galen, e që në fund të janarit marrë edhe diplomën e nivelit master për permanent-make up&tattoo. Shpresa, nga “Beauty Center Shpresa”, tregon se deri më tani i ka realizuar të gjitha planet, ama nuk ndalet së punuari e hulumtuari për një vizion të ri e edhe më inovativ në qendrën e saj estetike.

SHPRESA I KA EDHE DY QENDRA NË KOSOVË

Shpresa i ka edhe dy qendra në Kosovë, të cilat, gjithashtu, funksionojnë suksesshëm.

Dhe, për fund, afaristja dhe gruaja e fortë në jetë e profesion, i uron të gjithë për një vit të ri të mbarë e të suksesshëm.

“U them femrave se ne jemi të forta dhe mund t’ia dalim çdo kund dhe në çdo vend!”.

Nderim Neziri

Viti 2024 u dha epitetin prind shumë figurave tona publike

Viti 2024 do të mbetet si një nga viti më i dashur për shumë figura tona publike, meqë morën epitetin prind.



OLTA GIXHARI

Aktorja dhe opinionistja e njohur, Olta Gixhari, ka marrë epitetin nënë për herë të dytë nga djali i saj Zeo.



GRETA KOÇI

Muaji janar ishte një nga muajt më emocionues për Greta Koçin. Ajo solli në jetë djalin e saj të parë. Që atëherë e tash Greta nuk e ndau me ndjekësit e saj emrin e të birit.



ARLINDI DHE UEDA

Një nga çiftet që u bënë bashkë në një spektakël televiziv janë edhe Arlindi dhe Ueda.

Dashuria e tyre u finalizua me ardhjen në jetë të vajzës së tyre. Çifti aktualisht jeton në Gjermani.



SARA DHE BARDHI

Sara dhe Bardhi në vitin 2024 u bekuan me një vajzë.

Bardhi i dedikoi edhe këngë Neas së vogël.

KIARA DHE LUIZI

Një nga çiftet më të komentuar në mediet rozë janë Kiara dhe Luizi.

Ata morën epitetin prindër nga vajza e tyre Luna Maria.



ARTA NITAJ

Arta Nitaj flitet se është bërë nënë sivjet. Ajo zgjodhi që shtatzëninë dhe lindjen ta mbajë larg syrit mediatik, meqë është zhdukur nga të gjitha rrjetet sociale.



FJOLLA DHE ALBANI

Në prag të festave të dhjetorit, Albani dhe Fjolla sollën në jetë Andrrën, vajzë pas dy djemve. Vogëlushja ua zbukuroi jetën familjes Mehmeti.



MIKELA PUPA

Bukuroshja e emisionit "Përputhen" u bë nënë për herë të parë. Ajo solli në jetë një vajzë. E pagëzoi me emrin Aura.

"2 TON"

Muaj më parë edhe reperi "2 Ton" ka marrë epitetin babë për herë të parë. Ai momentin më të lumtur të tij nuk e ndau me ndjekësit e tij.



GLAUK KONJUFCA

Ditë më parë, politikani i njohur, Glauk Konjufca, u bë babë për herë të tretë - me vajzën e tretë. Vajzën e pagëzuan me emrin Kaona.

Edona Vllasaliu- Bajoku

Viti 2024 nuk ishte me fat për këto çifte...

Viti 2024 nuk qe i lehtë për disa çifte në botën e shou-bizit, me faktin se disa prej çifteve më të famshëm vendosën t'i japin fund marrëdhënies të tyre disavejeçare.



TEUTA SELIMI-PATRIKU

Një martesë disavejeçare e Teuta Selimit e Patrikut, të cilit i kanë dy fëmijë, përfundoi.

Dhuna fizike ishte ajo që solli deri te ndarja e çiftit të njohur.

Muaj më parë është shkruar në medie për një denoncim nga Teuta për ish-bashkëshortin e saj, por më pas ajo nuk bëri ndonjë reagim për publikun.

Sipas "Prive" Teuta Selimi tashmë është beqare.



ROMEO VESHAJ-HEIDI BACI

Romancën e tyre e filluan në "Big Brother VIP Albania", më pas shijuan kohën bashkë me disa pushime jashtë vendit.

Por, mesa duket, gjërat nuk shkuan ashtu si duhet dhe ndarja erdhi pas një periudhe të gjatë.

Përndryshe, arsyeja e ndarjes nuk dihet.



LUANA VJOLLCA-KRENAR ÇOÇAJ

Pas shumë sukseseve në karrierë të Luana Vjollcës dhe dashurisë disavejeçare me Krenarin, në media është përfolur për një ndarje të mundshme, por arsyeja nuk dihet, ani pse çifti nuk reagon asnjëherë për këtë.

Luana çdo herë është munduar t'i ikë syrit të publikut kur bëhej fjalë për jetën e saj sentimentale.



LUMBARDH SALIHU-KADER KICAJ

Njëjtë si çifti paraprak edhe Lumbardhi dhe Kaderi dashurinë e tyre e filluan në "Big Brother VIP Kosova", me ulje dhe ngritje në fillimet e tyre.

Çiftet u shfaqen kudo bashkë në syrin publik, por më pas, në një moment, treguan të vërtetën se marrëdhënia e tyre ka marrë fund, kurse arsyeja e ndarjes ishte tradhtia.

FERO-ARBENITA ISMAJLI

Edhe raporti i Feros me Arbenita Ismajlin ishte një nga temat më të përfolura gjatë vitit 2024, meqë me ndarjen e tyre është përballur shumë herë edhe gjykatat, me pretekst për kujdesin e vajzës.

Xheneta Spahiu

BOOM

receta



Valentina nga "Shija e Traditës"
sjell ekskluzivisht recetën
e bakllavës së Vitit të Ri



Valentina nga “Shija e Traditës” sjell ekskluzivisht recetën e bakllavës së Vitit të Ri

“Shija e Traditës” është një nga faqet më të njohura në “Instagram”, ku Valentina, mjeshtrja e gatimeve tradicionale, prezanton përditë recetat e saj.

Me përkushtimin e jashtëzakonshëm, duart e arta dhe prezantimin mbresëlënë, Valentina ka kthyer mijëra sy kah gatimet e dikurshme shqiptare, ato të sofrave tona.

Valentina, që jeton me familjen e saj në Mbretërinë e Bashkuar, punon me porosi gatimet me shijen më të mirë në botë dhe është më e njohura në komunitetin e shqiptarëve atje.

Për Vitin e Ri sjell recetën e bakllavasë...

Bakllava speciale e “Shija e Traditës”, recetë me petë të bëra në shtëpi. Bakllava është simbol i traditës dhe shijes së veçantë shqiptare, por kjo recetë, e bërë me përbërës të thjeshtë dhe shumë dashuri, do t’u bëjë të ndihen mjeshtrë i kuzhinës.

PËRBËRËSIT PËR PETËT:

- 8 vezë (3 të plota dhe 5 të verdha)
- 200 ml qumësht të freskët
- 200 ml kos të butë
- 200 ml vaj
- Gjysmë pako pluhur pjekës
- 1 lugë uthull të bardhë
- 1 kg miell të situr

PËRGATITJA:

1. Fillojmë duke rrahur vezët derisa të bëhen kremoze. Shtojmë qumështin, kosin dhe vajin, duke i përzier ngadalë për të krijuar një masë uniforme.

2. Shtojmë uthullën dhe pluhurin për

pjekje, të cilët ndihmojnë brumin të jetë i lehtë dhe i qëndrueshëm.

3. Miellin shtojeni pak nga pak, duke e përzier me duar, derisa të formoni një brumë të butë dhe elastik që nuk ngjitet në duar.

4. E lëmë brumin të pushojë 30 minuta, pastaj e ndajmë në toptha të vegjël dhe e hapim në petë të holla, duke përdorur niseshte për hapjen e petëve. E, ky është sekreti i suksesit të bakllavës!

5. Petët i vendosim në tepsi, një nga një, duke shtuar një shtresë arra të grira midis tyre. Mos harroni që dashuria është përbërësi kryesor!

6. Pasi të kemi vendosur të gjitha petët, e presim bakllavën në formën tradicionale dhe e pjekim në furrë të parangrohur në 180°C për 20 minutat e parë, më pas e ulim në 110°C për 4 orë, derisa të marrë një ngjyrë të artë ashtu siç duam.

SHERBETI:

1. Përgatitni sherbetin me një litër 1/2 ujë dhe dy kg sheqer e pak lëng limoni. Kujdes: Sherbeti duhet të jetë i nxehtë kur bakllava është e ftohtë për një shije perfekt.

U bëftë mirë dhe gëzuar festa e Vitit të Ri nga Valentina e “Shija e Traditës”!





MARITIM
MARINA BAY RESORT & CASINO
★★★★★



CALENDAR OF EVENTS

SPARKLY SEASON

MARINA BAY

MORE THAN 90 EVENTS AND 20 ARTISTS

I vjen në maje të hundës...

Nastradini *e qet gruan me e shitë!*

Ka kohë që pata lexuar thënien: “Burri që i flet gruas për dashuri, pak di ç’është dashuria!”.

Posa m’u kujtua thënia që e përmenda më lart, para meje, në Veternik të Prishtinës, takoj një çift bashkëshortor, i moshës që i takoj edhe unë...

Kanë thënë të vjetrit: “Bëj sevap se e mira nuk harrohet!”. Por, edhe thënien: “Ik nga sevapi, veç mos bë mëkat!”.

I mora ata në veturë.

Burri gjatë tërë rrugës nuk nxori fjalë nga goja.

Gruaja e kishte primatin dhe nuk ndalej së foluri. Foli për çdo gjë, kryesisht për çështje të moralit...

GRUAJA HYNI THELLË RRETH USHKURIT...

Gjatë rrugës mendoja: Ky zotëri ka dalë ta shesë gruan apo ta promovojë si të mençur?!

Por, mendimet e mia i ndërpreu ajo, kur me zë të lartë filloi të flasë për gjëra edhe më të thella rreth ushkurit...

“Sa të mundet njeriu, nuk është kurrë i vjetër!”, thotë haptazi ajo.

E, çka t’i them në prani të burrit të saj?!

“Nuk di zonjë, por ky muhabet që e ke hapur nuk është për t’u folur para burrit!”, i them, kinse për ta përmbyllur këtë temë.

“Pse, a kishte qenë më mirë të flitet kur nuk është burri këtu, a?!”, më pyet ajo dhe vazhdon: “Unë me burrin sillem si me shok dhe ai ma ka lejuar të flas pa dorëza”.

“Eh, nejtë, kjo është punë juaja, por mua më vjen keq të flas për këto gjëra, sepse jemi të panjohur dhe nuk më ka rastisur të flet grua para burrit si po flet ti, e po ndihem ngushtë!”.

“Pse, si ke lindur ti?!”

Kush të ka bërë ty?

A mos të kanë gjetur në lis, a?!

Këto gjëra janë normale dhe derisa ne, si komb, e ndalojmë gruan të flet haptazi, nuk ecim përpara!”, më thotë ajo me zë të ashpër.

“Sa mirë po ditka kjo, o Zot! Po, ku po m’i qet Zoti bash do të tilla në veturën time?!”, them me vete.

“Zotëri, deri ku keni me shku?”, e pyes burrin, sa për të ndërruar muhabetin.

“Ku do të ndalemi, grua?”, e pyet gruan, kurse ajo ma bën me dorë të ecim tutje.

ÇKA THOSHTE GRUAJA - BËHEJ!

Nuk dinin ku shkonin, por çka thoshte grua edhe bëhej! Në një moment mendja më shkoi te Nastradini, i cili, meqë ishte mërziur nga grua, e kishte qitur në pazar me e shitë.

Thashë me vete: “A thua, edhe ky që e kam në veturë e paska qitur gruan me e shitë dhe derisa të gjen blerës do endet poshtë e lart?! Eh, ku kemi ardhur, o Zot!”.

Keq, a?

Dhe, jo vetëm keq, por shumë keq, madje!

B. Bajrami

SINANI

GmbH & CO. KG

www.sinani-gmbh.de



www.sinani-gmbh.de

Gruaja më sheh ëndërr se kam vdekur!

Më ka kapë një gajle: Pse gruaja ime më thotë se më ka parë ëndërr të vdekur?

Ishte një ëndërr që përfundoi, në realitet, jo bash e mirë. E, të gjithë jemi pjesë e këtij realiteti: edhe të mençurit, edhe budallenjtë... E kisha lënë takimin për kafënë e mëngjesit me atë që e kisha pritur më shumë se dhjetë vjet. Vinte nga larg në Prishtinë dhe doja ta shihja me sy, meqë kishim shkruar gjatë e gjatë, me vite e vite. Nata po vinte. Bëra një dush në banjë dhe bëra shumëçka që për nesër të dukem sa më bukur. Më doli gjumi dy orë para mëngjesit

dhe u befasova për të parën herë në jetë se si nuk më doli asgjë këtë natë të ma prish të nesërmen: As nuk vdiq kush, as nuk u sëmurë kush, as nuk lëvizi kush... Uh, jetë o jetë, sa bukur kur nuk të prishet e nesërmja, sa mirë kur të thyhen parandjenjat e liga... Por, nuk ndodhi ashtu si e mendoja. Në mëngjes, teksa bëhesha gati të dilja në punë, gruaja më thotë se e ka parë një ëndërr të keqe. Hë, grua, ke parë ëndërr të keqe, a?! - i them.

Po, bile shumë të keqe! - ma ktheu. T'i marrtë të ligat! - i them. Kam parë ëndërr se vdiqe! - më thotë. Kush vdiq?! - i them. Ti, de! - ma ktheu. Unë, a?! - i thashë me habi. Ti, de ti! - flet ajo. Ishalla nuk bën vaki se ti duhet të martohesh edhe një herë! - ia ktheva. Ti nuk do të jesh më, se për mua nuk është gajle! - foli me një qeshje të madhe ajo.

S. M.



KENDA
CENTER

URIME
VITI I RI
NGA KENDA CENTER



Mos pritni vitin tjetër për të nisur ndryshimin!

Më lazdruan, tash janë në hall me mua!



Jam vajzë e vetme. Familja më kanë përkëdhelur shumë. Nuk ma prishnin për asgjë, madje nuk më pengonin as të dilja me shoqe e shokë kohë e pa kohë...

Nga lazdrimi i madh, në shkollë shkoja sa për të "shitur" mend.
Dhe, kur e mendoj tash një gjë të tillë, them sa budallaqe kam qenë!
Edhe kur u regjistrova në fakultet, më shumë rrija nëpër kafe e kafiqa sesa në ligjërata.

NJOHJA QË MA "NGULI" THIKËN NË ZEMËR!

Një ditë, teksa ndodhesha në një kafiq, pashë një burrë që më shikonte dhe nuk e largonte shikimin nga unë.
E, të nesërmen, kur shkova në ligjërata, për çudi, mu ai kishte qenë profesori im!
Dhe, ditë pas ditësh, një ditë ime shoqe më tregon se ai ishte i martuar me një profesoreshë, e cila punonte në shkollë të mesme. Emrin e kishte Diturie.
E, kur ma tha emrin, hyra në profilin e saj. Doli foto e saj: bionde, sykaltër, e bukur... Krejt një femër ndryshe krahasuar me mua!
Dhe, nga ajo ditë nisa ta emitoja në veshje...
Nisa një konkurrencë me dikë që ishte femër e martuar me atë që nisa ta dashuroja.
Kështu, dalëngadalë, isha një e burgosur e

atij pasioni, e kjo më shkaktonte nevrkosje dhe nisa të dobësohesha!

KRIJOVA LIDHJE ME NJË STUDENT QË TA HARROJA PROFESORIN!

Pa dashje nisa një lidhje me një student të grupit, më shumë që ta harroja profën dhe gruan e tij, e cila sa herë që e shikoja në profilin e saj më dukej edhe më e bukur... Por, teksa puthesha me tim "shok" të grupit, e mendoja profesorin tim, fantazoja çdo gjë të mundshme me të...
Dhe, që të gjeja një "shpëtim shpirtëror", vendosa t'i braktisja studimet!
U regjistrova në një fakultet privat, fakultet në të cilin e dija se nuk do e takoja profën dhe do lirohesha njëherë e përgjithmonë nga dhembja që kisha në shpirt.
Mirëpo, nga dashuria e madhe që kisha për profën nisa të sorolletesha poshtë e lartë dhe në atë gjendje i kalova tre vjet, kur edhe rastësisht e takova profën në të njëjtin kafiq, ku e kisha takuar edhe për herë të parë.
Në çast më ndali zemra.
Shikimet tona u ndeshën dhe më buzëqeshi.
Të nesërmen hyra në profilin e gruas së tij,

profil në të cilin nuk kisha hyrë tre vjet, që nga dita kur edhe e lashë fakultetin dhe nuk doja më të merresha me ta.
Por, për çudi, të gjitha fotot me profën biondja i kishte larguar nga profili i saj! Mbeta e hutuar...
A thua, qenkan ndarë?! – i bëra pyetje vetes.

U PUNËSOVA NË BANKËN KU PUNONTE EDHE PROFA!

Dhe, që të isha sa më afër tij, e pyeta një shoqe timin se profa, veç punës në fakultet, a punon edhe gjetiu a jo.
Më tha se punon në një bankë dhe për këtë ishte e sigurt.
Andaj, meqë nga ajo ishte ndarë, meqë fotot ishin zhdukur, bëra gjithçka të isha afër tij...
Kështu, aplikova dhe më pranuan në punë në të njëjtën bankë ku punonte edhe profa.
Por, edhe në bankë asgjë nuk kisha më shumë me profën sesa përhëndetje të çdoditshme dhe si me çdo kë tjetër...
Dhe, pus atëherë kur isha studente, pus tash kur jam e punësuar!

Liridona

Djemtë a vajzat

i ndërrojnë më shumë partnerët?

Vajzat janë ato që kanë më shumë partnerë, por ato i fshehin lidhjet e tyre, që të mos komprometohen para familjes dhe rrethit të tyre...

E, cilët kanë më shumë partnerë?

LIRJANA,

MOTËR MEDICINALE:

- Nuk është e vërtetë se vajzat kanë më shumë partnerë! Sepse, të rralla janë ato vajza që kanë dëshirë të kenë shumë lidhje, t'i ndërrojnë partnerët e tyre. Sidoqoftë, nëse ndonjëra prej tyre ka pasur më shumë lidhje, është pasojë e largimit të meshkujve prej saj, e jo nga dëshira e saj që t'i ndërrojë meshkujt. Një shoqe imja një ditë më tha: S'ka si të mos kesh shumë meshkuj, sepse secili të tradhton, andaj lidhjet zgjasin pak. E, kjo gjë, fatkeqësisht, po u shkon për dore djemve! Dhe, një jetë e tillë po u konvenon...

DONJETA, MJEKE:

- Djemtë e ditëve tona shtiren të mode-ruar, sa s'ta merr mendja! E, në këtë aspekt, prijnë ata të Diasporës, të cilët në vendet ku jetojnë vrapojnë pas plakave, e te ne, në Kosovë a Shqipëri, shesin mend me vetura të shtrenjta para femrave!

Për ta nuk ka rëndësi a je e virgjër a jo!

Me rëndësi është ta arrijnë qëllimin e tyre dhe kur të kthehen në vendet ku jetojnë e punojnë të shesin mend se në Kosovë e ka një dashnore dhe po kënaqet me të! E, mu të tillët, kur duan të martohen, kërkojnë vajza të virgjëra! Marrëzi, a?

BESËMIRI, **AUTOMEKANIK:**

- Nuk mendoj se gjithmonë vajzat janë viktimë e djemve, meqë disa që i njoh, e vijnë në servis tim për mirëmbajtjen e veturës së tyre, e mbajnë kryet përpjetë, sikur ta kenë çliruar Kosovën, e jo NATO-ja e UÇK-ja! Të tillat, e që i njoh, nuk ka djalë që mund t'i qojë në shtrat pa dëshirën e tyre, sepse krenarinë e kanë të madhe.

HESETI, GAZETAR:

- Një vajzë e kam dashur në jetë dhe atë

sot e kam në shtëpi.

DRILONA, SHITËSE:

- Të rrallë sot janë djemtë që dinë ta respektojnë si duhet vajzën (femrën). Rrugës shkojnë me kryet përpjetë rahovan dhe çka gjejnë para vetës mundohen ta përlajnë përpara! Pra, të rrallë janë ata djem që meritojnë të respektohen nga vajzat. E, të gjorat ne, edhe kur i mbushim 30 vjet, ende hamendemi të martohemi a jo, sepse, pas disa muajsh martesë, "tipi" gjen një më të re dhe të thotë nuk paskemi qenë për njëri-tjetrin! Tmerr, a?!

NË VEND **TË PËRFUNDIMIT**

Dashtë Zoti të rinjtë tanë të mbushen mend e ta shohin jetën realisht, e jo si në filma!

Diturie Haxhaj



A do të mbetët çift pa u ndarë?

Gjatë dhjetë muajve të vitit të sivjetmë në Kosovë (nga janari deri në tetor) 1.408 çifte i dhanë fund martesës së tyre. Pse?

Numri më i madh i shkurorëzimeve është regjistruar në muajin janar të vitit që po e lëmë pas: 155 çifte i kanë dhënë fund martesës së tyre!

Ndërkaq, më muajin shkurt ka pasur 151 shkurorëzime ose 4 më pak.

Në mars ka pasur 149 raste të shkurorëzimeve.

Në prill numri i shkurorëzimeve ka pësuar rënie të lehtë. Në këtë muaj 114 çifte i kanë dhënë fund martesës së tyre.

Ndërsa, në maj ka pasur sërish rritje të numrit të shkurorëzimeve, e numri i tyre ka shkuar në 138 raste.

Në qershor janë regjistruar 118 raste të shkurorëzimeve.

Në korrik janë shkurorëzuar 142 raste.

E, në gusht 136 raste, ose 6 më pak.

Në shtator kanë qenë 152 shkurorëzime.

Ndërkaq, në tetor 153 raste të shkurorëzimeve.

NË CILAT QYTETE KA PASUR MË SHUMË SHKURORËZIME?

Qytetet të cilat prijnë me numrin më të madh të shkurorëzimeve gjatë muajit tetor janë: Peja, Prizreni, Podujeva dhe Ferizaj, me nga 13 raste të shkurorëzimeve. Më pas vjen Gjakova me 11 raste dhe

Suhareka me 10 raste.

Për çudi, Prishtina, si kryeqytet dhe me numër më të madh të banorëve në Kosovë, ka dukshëm numër më të vogël të shkurorëzimeve, meqë gjatë muajit tetor në kryeqytet vetëm 5 çifte i kanë dhënë fund martesës së tyre.

PSE PO NDAHEN KOSOVARËT?

Shkaqet pse çiftet po ndahen me të madhe në Kosovë nuk janë analizuar apo, së paku, nuk janë bërë publike nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Shtrohet pyetja: Pse po ndahen kosovarët?




**Blej banesë të gatshme dhe
përfito zbritje deri më 31 Dhjetor!**

KOMPLEKSI DARDANIA

PRIZREN

+383 48 450 888



**Blej banesë të gatshme dhe
përfito zbritje deri më 31 Dhjetor!**

**CIMA TOWER
FERIZAJ**

+383 49 601 080

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A do të dal nga kriza?

Përshëndetje, jam nga Tetova. Dua të di se a kam magji, sepse çdo gjë që filloj me ndonjë biznes më ndalet shpejt...

A do të dal nga kriza që e kam për momentin?

“Tetovari 2024”

Përgjigje:

Shoh se do ta shesësh objektin, sepse me biznese ke filluar dhe nuk po të ecin.

Kah pranvera do ta arrish synimin tënd.

Por, fakti që nuk shkon diçka është ai që mund t'i gëlltis edhe mjetet financiare që do i marrësh nga objekti që do e shesësh dhe mendo mirë në çka do i investosh...

Andaj, pa ide të qarta dhe pa qasje profesionale mos e shit objektin, sepse mund të pësosh edhe më keq.

Me burrë nuk po më jeto- het!

Përshëndetje, jam grua 46 vjeçe, jetoj në Zvicër. Ka kohë që burri nuk ka ndjenja për mua.

Jam munduar në shumë aspekte ta ofrojë pranë vetes, duke e ringjallur nga ana emocionale, por kot.

Kemi biseduar herë pas herë për këtë problem, por thotë se me të gjithçka është në rregull!

Më është bërë bajat jeta me të dhe nuk di çka të bëj tutje. Kështu nuk jetohet, e di, ama çka të bëj nuk po di?!

“Dona, Cyrih”

Përgjigje:

Para së gjithash, duhet të dihet e vërteta pse ka ndodhur ky defekt. Nëse ndryshimi ka ndodhur për shkakë shëndetësore, duhet ta pranosh jetën e tillë si bashkëshorte e tij besnike. E, nëse ndryshimi te burri ka ndodhur shkaku i aventurave të tij, e drejta jote për të zgjedhur një mënyrë jete që të përshtatet është legjitime.

Pse vëllai nuk flet me askënd në shtëpi?

Përshëndetje zonja magjistare. Jam një vajzë 28- vjeçare nga një fshat i Gjakovës. E kam kryer fakultetin, por

nuk ma merr mendja të punësohem, sepse ka një vit që frikësohem shumë e nuk ndjem rehat askund dhe me asgjë.

Edhe vëllai e ka kryer fakultetin, por është mbyllur shumë në vete.

Jetojmë nga pensioni i babait dhe, më duket, po bëjmë mëkat me babën, sepse gjithmonë thoshte mezi po pres ta kryeni fakultetin dhe të punësoheni... Të lutem, çka po ndodh me ne?

“E bukura vajzë”

Përgjigje:

Në rrethanat tuaja sikur po i shpjegon ti gjërat, ka mundësi të keni magji në shtëpi. Shoh se duhet ta hulumtoni një orman të vjetër me rroba të papërdorshme dhe kërkoj t'i kontrolloni xhepat, sepse në një xhep të një palltoje do të gjeni diçka në formë trekëndëshi të mbështjellë dhe bashkë me rroba digjni!

Kështu, pas një kohe, ty do të të largohet frika, kurse vëllai do të hapet në shtëpi për të qenë komunikativ dhe i dobishëm.

E dua një tjetër, a të nda- hem nga burri?

Kam shumë besim në ty, magjistare!

Të kam shkruar para pesë vjetësh kur isha në prag të martesës dhe fjala ka qenë pikërisht për këtë person, te i cili dua të kthehem...

Atëbotë të kam pas shkruar se a ia vlen të martohem me burrin që e kam sot dhe ti me the se nuk duhet të martohesh me askënd derisa e do dikë tjetër...

Por, ndodhi si ndodhi dhe u martova.

U mundova ta dua burrin, por nuk po mundem!

Jam e bindur se e dua personin që e kam pasur dikur dhe jam takuar me të edhe pasi është martuar...

Në martesë nuk jam e lumtur me burrë, por as të martohem me atë që e dua nuk mundem, meqë ai tash është i martuar...

Si të veprojmë?

Përgjigje:

Unë nuk shoh se do të martohesh me personin që e do, sepse keni qenë në lidhje e nuk jeni martuar!

Mos u ndajë nga burri, sepse mund ta shkatërrosh edhe këtë që e ke!

A kam pasur magji që e zgjodha vetë burrin?

Zonja magjistare, jam e martuar, 27-vjeçare, jetoj në Mitrovicë.

Kam dyshime me veten time, apo mund të më kenë bërë diçka kur dola të shihem me djalin që tani e kam burrë! Kur e pashë për herë të parë m'u duk shumë i bukur. Por, qëkur jemi fejuar, më duket krejt tjetër njeri...

Të lutem, a do të jetoj me të deri në fund të jetës?

"Nusja e dëshpëruar"

Përgjigje:

Ke pritur gjashtë vjet të fejuhesh dhe dëshira për t'u fejuar ka bërë që ai të të duket më i bukuri në botë!

E, kjo ndodh te shumë femra dhe, pastaj, shohin se kanë gabuar, por, realisht, disa gabime janë të vonuara, sepse nuk je e gatshme as e guximshme për ndryshime.

Ajo që unë shoh është se do të jetosh me të dhe do i keni tre fëmijë.

Jam në krizë të vras veten!

Jam 29-vjeçare, jetoj në rrethin e Rahovecit.

Kam humbur çdo gjë për një djalë që e dua shumë dhe mendoj se më ka dashur edhe ai mua, meqë jemi në lidhje që nëntë vjet...

Deri sivjet kurrë nuk kemi pasur probleme, derisa gjatë verës shkoi në Zvicër që të punojë punë sezonale.

Një i afërm i familjes së tij para pak ditësh më tha se ai më nuk do të kthehet, kurse mua më thotë veç sa nuk jam kthyer!

Të lutem, a do të jemi bashkë?

"E molisura"

Përgjigje:

Jeni që nëntë vjet bashkë, e dinë familjet tuaja, kurse nuk e keni zyrtarizuar fejesën! Por, mendimi yt depresiv për ta dënuar veten, është ideja më e keqe që mund ta bëni!

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Sidoqoftë, nuk je në udhë pa krye. Nuk je në shtëpinë pa derë, nga nuk ke dalje...

Ke zgjidhje, meqë ai nuk ka hequr dorë prej teje dhe as që shoh se po heqë dorë.

Shoh se ai po mundohet të krijojë një siguri për ekzistencë, në mënyrë që kur të martoheni të keni kushte për jetesë...

*Dhe, e rëndësishme është se shoh bashkimin tuaj në fund të rrugës.
Urime!*

Jam në rrugë pa dalje!

Përsëndetje magjistare!

Paraqitem nga Franca. Jam grua 30-vjeçare. E kam një fëmijë dhe jam shtatzënë sërish.

Burri më ka braktisur dhe ka krijuar familje tjetër.

E, unë as nuk kam qëndrim të rregullt në Francë, e as nuk kam ku të kthehem!

Si do të jetë e ardhmja ime?

"Nëna me fëmijën në bark"

Përgjigje:

Duhet t'i shkosh deri në fund mundësisë së statutit të azilantes, sepse me dy fëmijë zor është ta sigurosh jetën në Francë apo gjetiu.

E, sa i përket burrit, pas një kohe do t'u kthehet fëmijëve të vet, sepse as me tjetrën nuk do t'i ecë puna mirë...



Më do a nuk më merr për grua!

Përhëndetje Redaksi!

Jam 31-vjeçare, në lidhje me një person me të cilin duhem shumë, por martesë jonë nuk është e mundur. Kështu më thotë ai!

Ai kërkon prej meje ta refuzoj çdo ofertë për fejesë a martesë, sepse, po thotë, kam dëshirë të vendos me mua! E, mua po më duket se ato janë vetëm flalë dhe asgjë më shumë!

Lena, Gjakovë



5 shenjat më me fat të horoskopit në vitin 2025

Viti 2025 do të jetë një vit me shumë surpriza dhe me disa shenja që do të shohin se jeta e tyre do të ndryshojë rrënjësisht...

Viti 2025 do të sjellë disa ndryshime të mëdha për disa shenja të horoskopit, Dhe, sa i përket sektorit profesional, këto shenja do të zgjedhin një rrugë të re, duke ndjekur një karrierë ndryshe.

Parashikimet astrologjike "flasin" për suksese të mëdha financi-

are për pesë shenja specifike të zodiakut.

Portofoli i tyre do të mbushet me para dhe ata do të shohin që kursimet e tyre do të rriten deri "në qiell". E, cilat janë ato?

Ato janë: Dashi, Ujori, Demi, Gaforrja dhe Binjakët.





Si “jetova” në vitin 1523?

Dokumentet e Perandorisë Osmane nga Arkivi i Stambollit, ishin bërë sebeb për të reflektuar në një serial jetën perandorake në shekullin që njihet si “Lulëzimi i Turqisë”, në rritjen e ushtrisë së shpatave dhe artilerisë së rëndë, që kishte përlarë përpara truallin e Evropës.

Një shtet si Turqia, që i pushtonte lehtë kontinentet, ishte bërë i frikshëm deri në Romën e njohur të krishterimit, e për në Gadishullin Arabik (Egjypt, Siri e Irak) të mos flasim, meqë aty ku lëshonte sulltani gishtin në hartë – e pushtonin ushtarët.

E, pushtimi i tokave të Arbërit veç ishte kryer në kohën e Sulejmanit të Madhërishëm, sepse familja e Kastriotëve u dobësua për tre djem të vet, ndër të cilën më i vogli, Gjergji, mbijetoi për t’u bërë luftëtar

ndërkombëtarisht i njohur, duke u kthyer në Shqipëri për ta luftuar Turqinë...

SI U BËRA “PJESË” E VITIT 1523?

Kisha rënë me fjet pak më herët se zakonisht.

Kushedi pse më shpui ëndrra në shtetin e pushtimeve të egra...

Nuk di pse dhe si kisha arritur atje në atë kohë, por unë jetoja krah për krah me Par-

galiun, kryeministrin shqiptar nga Parga e Çamërisë, apo kjo kishte ndodhur për faktin se tri net më parë e kisha shkruar një poezi për Çamërinë, konkretisht për Pargën e rrethuar në të tri anë nga deti. Kisha lexuar se si te “Mulliri i Meqës” serbo-grekët kishin prerë shqiptarë. Andaj, në Pargë ishin bërë shumë vende emra të shenjtë, shkaku i masakrimit të popullatës pargase, që pas masakrave kishin ikur në drejtim të Stambollit dhe Tiranës.

SI U GJENDA NË OBORRIN E SULLTANIT?

I thashë gruas se nuk kisha dashur të vdes pa e vizituar selinë perandorake me të gjitha objektet dhe parqet e luleve dhe me ahurit e kuajve që i importonin nga të gjitha anët e botës së pushtuar për punë luftarake e komunikacioni, në kohën kur trafiku bëhej nën trokun e kuajve. Isha ulur në kolltuk pranë parkut dhe përballë meje loznin dy fëmijë, por u bërtita të largoheshin, meqë topi binte në kopsht dhe i ndrydhte lulet. Dhe, në çast vjen Symblyl Aga, i matur në ecje, i veshur me pelerinën e gjelbër dhe mahramën e shenjtë që tregonte pozitën e tij në harem. I bërtas Symblyl Agës të kthehet pas dhe të mos kalonte nëpër park.

PËRBALLJA ME KRYEMINISTRIN E PARGËS

Por, teksa i bërtita Symblyl Agës, drejt meje vinte kryeministri nga Parga ime shqiptare e Çamërisë, por nuk e dija se a do ndikonte gjë se të dy jemi shqiptarë... Ia bëra me dorë të ulej. Shpatën e kishte në brez dhe herë pas herë e çonte dorën në dorezën e saj, duke reaguar nën instinktin e frikës së një sulmi që mund t'ia bëja unë.

FRIKA NGA GRUAJA...

Tek po qëndroja stoik te parku, duke i kthyer të gjithë në devijim të rrugës, goxha shumë u mbusha vetëbesim e guxim se nuk kishte kush që mund të m'i bënte dy fjalë... Ndërkohë erdhën dy kalfa të haremit, të cilat i qortova për padrejtësi ndaj robërshave që detyroheshin të shërbenin aty, përkundër faktit se ua kishin vrarë familjarët! Mbani drejtësi, u thashë dhe sytë më shkuan te stolitë prej ari që i kishin në qafë. Dhe, po t'ua futja duart nëpër gjoks, do ua gjeja strajcat me dukat, që i fitonin nga spiunimi të sulltaneshat për punë morali. Por, u ndala, sepse në çast m'u kujtua profesori i Fakultetit të Mjekësisë, të cilin e patën larguar nga puna me akuzën për ngacmim seksual, meqë u kishte thënë studenteve se po t'i shihje nën veshje, do ua gjente përgjigjet e pyetjeve nga provimet që i mbanin ato ditë... Por, boshtin e mendimeve ma ndërpreu gruaja, e cila erdhi si shigjeta nga qielli... "Ku je deri tash?! A këtu të kam çuar për t'u marrë erë luleve, a?!". Dhe, brof më doli gjumi, duke ma ndërpreur ëndrrën e papërsëritshme të kohës së burrave të perandorisë...

S. M.

Ndodhi e rrallë



Pamje nga Dinoshë

Në cilin fshat shqiptar del uji nga druri?

Çdo vit, në një livadh në fshatin Dinoshë të Tuzit, mund të shihet uji që buron nga trunngu i një mani 100-vjeçar. Sipas banorëve, ky fenomen zgjat vetëm një ose dy ditë

në vit. Nuk ka ende ndonjë shpjegim se pse ndodh ky fenomen natyror, porse pamjet tregojnë një fushë të mbushur me ujë shkaku i ujit që del nga trunngu.

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

KOSOVARIA | 43



Lum si ajo...

Ariana Musliu-Shoshi është e lindur në Prishtinë. Shkollimin fillor e kreu në Skenderaj dhe Prishtinë, ndërsa shkollën e mesme e filloi në Gimnazin "Xhevdet Doda" për të vazhduar në "Conrad Weiser High School" në Pensilvani të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku edhe u diplomua. Edhe pse e pranuar në Universitete prestigjioze në SHBA me bursa të plota, Ariana i rikthehet familjes dhe vendit. Nga viti 2004-2008 ndoqi dy univer-

sitete paralelisht në drejtimin Shkenca Politike në Universitetin e Prishtinës dhe Menaxhim të Politikave Publike në "Rochester Institute of Technology", në bashkëpunim me Universitetin Amerikan në Kosovë dhe të dy universitetet i ka përfunduar si studente e dalluar, duke përfituar bursë nga USAID-i dhe Universiteti i Prishtinës. Nga vitin 2009-2011 i ka ndjekur studimet master për Administrim Publik në "Rochester Institute of Technology"

(Universitetin Amerikan në Kosovë) dhe nga viti 2012-2014 i ka përfunduar studimet master për diplomaci në Universitetin e "Oxfordit" në Angli. 12 vjet ka punuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku nga viti 2007 ishte udhëheqëse e njësisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Momentalisht është deputete shumë e zëshme dhe me shumë merita në Parlamentin e Kosovës nga radhët e PDK-së.



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE